



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:920092

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636979

KE.nr.1630/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit N.T.P. “Vëllezërit Neziraj” me seli në fshatin Llukë e Epërm, Komuna e Deçanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.F., avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia e Pyjeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.K. përfaqësuese nga Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 25.04.2023, në prezencë të autorizuarve të paditësit dhe të paditurit, me datën 29.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P. “Vëllezërit Neziraj” me të cilën ka kërkuar që detyrohet i padituri Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia e Pyjeve të Kosovës, që paditësit t’ia realizoj pagesën e mbetur në shumën e përgjithshme prej 43,851.25€ në emër të blerjes së dy kombi busëve frigo, gërrshërëve dhe për punët e mbetura ndërtimore mbi bazën e vendimit për mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural me shenjën 07/4 numër 4577 të datës 17.11.2016 me numër Ref. AZHB 07/4/1229, me kamatë vjetore në lartësi prej 8% deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi N.T.P. “Vëllezërit Neziraj”, me datën 07.03.2017, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi ndaj të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) – Agjencia e Pyjeve të Kosovës (AZHB), me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos ekzekutimit të kontratës, gjegjësisht mos ekzekutimit të pagesës sipas kontratës, të ia paguaj shumën prej 43,851.25€ me kamatë vjetore në lartësi prej 8%, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Sipas padisë, paditësi kishte qenë përfitues i mbështetjes financiare nga Programi i Zhvillimit Rural me shenjën 07/4 numër 4577 të datës 17.11.2016 me numër Ref.AZHB 07/4/1229, AZHB, MBPZHR për investimin në vlerë prej 298,481.94€, ku i padituri ishte paraparë që të financoj projektin prej 50 dhe 60% të vlerës së investimeve për vitin 2015. Siç thekson në padi, i padituri nuk ka realizuar pagesën sipas vendimit të lartcekur pasi që sipas tij nga raporti i kontrollit në teren është nxjerr vendimi 07/03 136 i datës 30.01.2017 ku i padituri ka refuzuar pagesën për dy kombi bus frigo në shumën prej 29,500.00€ për copë me arsyetimin se është pësuar ndryshimi i shasisë. Sipas paditësit i padituri është dashur që t’i paguaj 50% të shumës si në faturë për dy kombi busët frigo shumën 30,000.00€, për gërrshërë shumën prej 7,250.00€ dhe për realizimin e projektit shumën prej 6,601.25€, në shumën e përgjithshme prej 43,851.25€.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar me pretendimin që e njëjta është vërtetuar si për nga baza ashtu edhe nga lartësia me të gjitha provat e administruara gjatë këtij procesi e po ashtu edhe me ekspertizat e kryera dhe ka theksuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi e ka realizuar qëllimin për të cilin e ka përfituar grantin dhe kjo është dëshmuar në të gjitha procedurat. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të obligohet i padituri që t’ia realizoj pagesën në shumën prej 43,851.25€, me kamatë vjetore në lartësi prej 8% e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë nga data 07.03.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së OAK dhe atë shumën prej 208.00€ në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 1,080.00€ për mbajtjen e katër seancave, shumën prej 200.00€ në emër të ekspertizës së makinerisë, shumën prej 200.00€ në emër të ekspertizës së ndërtimtarisë si dhe shumën prej 250.00€ në emër të ekspertizës financiare apo në total shumën prej 1,939.00€.

I padituri përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se sipas legjislacionit në fuqi paditësi nuk i është përmbajtur planit të biznesit dhe kërkesave të përcaktuara me UA Nr.01/2015 për masat e përkrahjes në bujqësi, i cili e përcakton edhe mënyrën e pagesës 50% të projektit që jepet si avans, pas nënshkrimit të kontratës dhe 50% pas përfundimit të investimit. Ka theksuar se me rastin kur Komisioni i AZHB ka dal në vendin e ngjarjes për verifikim për kryerjen e investimeve me datë 05.10.2016 ka konstatuar se numër i shasisë në pro faturë nuk është i njëjtë me numrin e shasisë në kombi bus, ku sipas të paditurit në këtë rast janë shkelur dispozita ligjore nga neni 12 par.5 nën par. 5.5 të UA 01/2015 për Masat e përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Vitin 2015 i cili përcakton se në bazë të raportit të kontrollit të faturave të dorëzuara me kërkesën për pagesë AZHB lëshon edhe vendim për pagesë.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve të thëna gjatë shqyrtimit gjyqësor duke kundërshtuar edhe më tej padinë e paditësit si të pa bazuar në ligj. Ka shtuar se paditësi ka mundur vendimin e atakuar ta atakoj në konflikt administrativ ashtu siç parashihet me nenin 14 të Ligjit mbi Gjykatat ku në vendimin kontestues është dhënë edhe këshilla juridike në afat prej 30 ditëve e drejta për ushtrimin e ankesës. Ka theksuar se vendimi kontestues është i datës 30.01.2017 ndërsa padia e paditësit e datës 07.03.2017 dhe i njëjti pasi ka humbur afatin për të hapur konflikt administrativ i është drejtuar gjykatës në Departamentin Ekonomik dhe krejt çështja buron nga vendimi i datës 30.01.2017. Ka shtuar se i padituri ka vepruar sipas UA dhe ka vendosur bazuar në atë se paditësi nuk i ka kryer obligimet sipas planit të biznesit dhe kushteve e kriterëve të përcaktuara në UA, andaj i padituri i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilën refuzon kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Vendimit nr. 07/4/4577 i datës 17.11.2016, Raporti nga kontrolli në teren i datës 01.02.2017, Letër informim nr. 07/4 nr. 4576 i datës 17.11.2016, Vendimi nr. 07/4/136 i datës 30.01.2017, Urdhër pagesë kombëtare në shumë prej 29,500.00€ i datës 25.10.2016, Dokumenti unik doganor R50846 i datës 28.10.2016, Urdhër pagesë kombëtare në shumë prej 29,500.00€ i datës 25.10.2016, Dokumenti unik doganor R50850 i datës 28.10.2016, Faturë nr. A/6-E e datës 10.06.2016 dhe Urdhër pagesa e datës 13.06.2016, Fatura nr. 17-22/16

e datës 28.10.2016, Fatura nr. 17-22/15 e datës 28.10.2016, Ankesa e këtu paditësit drejtuar të paditurit në procedurë administrative, Raporti i vlerësimit të aplikacionit i datës 23.05.2015, Letër informim nr. 07/4-1944 i datës 09.07.2015, Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr. 13/2015 datë 10.07.2015, Kërkesës për pagesë e datës 16.09.2019, Tabela e kostove sipas kërkesës për pagesë, Pro fatura nr. 044/2016 e datës 16.08.2016, Pro fatura nr. 045/2016 e datës 16.08.2016, Kontrolli pas investimit dhe para pagesës së plotë e datës 16.09.2016, Letër informim e datës 31.10.2016, Vendim i datës 31.10.2016, Dokumenti unik doganor R 46750 i datës 06.10.2016, Urdhër pagesë e datës 15.09.2016, Polica e sigurimit nr. 0006024190 e datës 31.10.2016, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti i makinerisë i datës 02.10.2018, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti i ndërtimtarisë i datës 11.10.2018, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga ana e ekspertit financiar i datës 20.12.2018.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi sipas Vendimit nr. 07/4/4577 të datës 17.11.2016, kishte përfituar mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural nga i padituri në shumën maksimale prej 298,481.94€, në masën “Investimet në Asete Fizike në Ekonomi Bujqësore, Përpunim dhe Tregtimin e Produkteve Bujqësore, në Diversifikimin të Fermave dhe Zhvillimit i Bizneseve dhe Ujitje të Tokave Bujqësore” në nën masën 103.2. Përpunimi i Mishit.

Po ashtu midis, palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese edhe nënshkrimi i Kontratës për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr. 13/2015 date 10.07.2015 dhe se nga i padituri është pagesa e këstit të parë në vlerë prej 99,631.25€.

Nga prova Kontrolli pas investimit dhe para pagesës së plotë e datës 16.09.2016, gjykata konstaton se i padituri kishte kryer kontrollin e dytë tek paditësi ku me c rast ka evidentuar se kombi busët nuk kanë numrin e njëjtë të shasisë me kombi busët të cilët janë pjesë e faturave, janë aprovuar vetëm një palë gërshërë dhe jo dy palë, si dhe tek ndërtimi i rezervuarëve për trajtimin e mbetjeve mungon pllaka e njërit rezervuar.

Nga Letër informimi e datës 31.10.2016, gjykata konstaton se i padituri për shkak të gjetjeve nga raporti i kontrollit të investimit i datës 16.09.2016, kishte njoftuar paditësin se vlera e autorizuar

e përkrahjes publike është 55,778.00€, ashtu që bazuar në raportin nga terreni ka pranuar gërshërt një palë sipas projektit dhe vlera sipas çmimores së AZHB-së, kombi busët janë të papranueshëm sepse nuk përputhen të dhënat në faturë me përshkrimin teknik dhe tek ndërtimi i rezervuarve për trajtimin e mbetjeve nga raporti i terrenit shihet se mungon pllaka e njërit rezervuar.

Nga Vendimi nr. 07/4/4577 i datës 17.11.2016, gjykata ka konstatuar se i padituri ka autorizuar shumën për pagesë prej 55,778.00€, ndërsa ka njoftuar palët se mund të ushtrojnë ankesë në AZHB brenda afatit prej 15 ditëve.

Nga prova Ankesa e paditësit drejtuar të paditurit në procedure administrative, gjykata konstaton e paditësi kishte ushtruar ankesë në procedurë administrative, ndërsa nga Vendimi nr. 07/4/136 të datës 30.01.2017 gjykata konstatoi se i padituri ka refuzuar ankesën e paditësit dhe të njëjtën e ka udhëzuar se mund të iniciojë procedurë pranë organeve kompetente gjyqësore.

Për vërtetimin e pretendimeve të paditësit lidhur me lartësinë e kërkesë padisë gjykata ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës teknike, ekspertizës së ndërtimtarisë dhe ekspertizës financiare të cilat janë nxjerr dhe shqyrtuar gjatë seancave në këtë procedurë kontestimore.

Po ashtu Gjykata si provat i ka vlerësuar edhe provat si Raporti nga kontrolli në teren i datës 01.02.2017, Letër informimi Nr. 07/4 nr. 4576 i datës 17.11.2016, Urdhër pagesa kombëtare në shumë prej 29,500.00€ i datës 25.10.2016, Dokumenti unik doganor R50846 i datës 28.10.2016, Urdhër pagesë kombëtare në shumë prej 29,500.00€ i datës 25.10.2016, Dokumenti unik doganor R50850 i datës 28.10.2016, Fatura nr. A/6-E e datës 10.06.2016 dhe Urdhër pagesa e datës 13.06.2016, Fatura Nr. 17-22/16 e datës 28.10.2016, Fatura Nr. 17-22/15 e datës 28.10.2016, Kërkesës për pagesë e datës 16.09.2019, Tabela e kostove sipas kërkesës për pagesë, Pro fatura nr. 044/2016 e datës 16.08.2016, Pro fatura nr. 045/2016 e datës 16.08.2016, Kontrolli pas investimit dhe para pagesës së plotë e datës 16.09.2016, Letër informimi e datës 31.10.2016, Vendimi i datës 31.10.2016, Dokumenti unik doganor R 46750 i datës 06.10.2016, Urdhër pagesa e datës 15.09.2016, Polica e sigurimit nr. 0006024190 e datës 31.10.2016, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti i makinerisë i datës 02.10.2018, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga eksperti i ndërtimtarisë i datës 11.10.2018, Mendimi dhe konstatimi i dhënë nga ana e ekspertit financiar i datës 20.12.2018, por ka konsideruar se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje pasi që gjykata nuk bëri vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë në mungesë të bazës juridike.

3. Baza ligjore

Nga pretendimet e paraqitura në padi dhe në seancat e zhvilluara pranë gjykatës, gjykata gjeti se paditësi pretendimet e tij i mbështet në nenin 136 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili përcakton se: *“1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. 3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.”* dhe në nenin 137 i cili përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*

4. Vlerësimet e gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, për arsyet si në vijim:

Paditësi sipas Vendimit me shenjen 07/4 nr. 4577, të datës 17.11.2016, kishte përfituar mbështetje nga Programi i Zhvillimit Rural nga i padituri në shumën maksimale prej 298,481.94€, në masën “Investimet në Asete Fizike në Ekonomi Bujqësore, Përpunim dhe Tregtimin e Produkteve Bujqësore, në Diversifikimin të Fermave dhe Zhvillimit i Bizneseve dhe Ujitje të Tokave Bujqësore” në nën masën 103.2. Përpunimi i Mishit.

Lidhur me mbështetjen financiare të përfituar i padituri pas konstatimit të gjendjes në teren përmes raportit lidhur me mbështetjen financiare të përfituar i padituri pas konstatimit të gjendjes në teren përmes raportit të kontrollit të datës 16.09.2016, kishte autorizuar përkrahjen publike vetëm për shumën në lartësi prej 55,778.00€, për shkak të konstatimeve të cekura më lartë, duke mos ofruar mbështetje në tërësi sipas vendimit dhe kontratës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit.

Ndaj këtij vendimi paditësi kishte bërë ankesë e cila ishte refuzuar nga i padituri, mirëpo paditësi nuk kishte iniciuar konfliktin administrativ përmes të cilit do të shqyrtohej ligjshmëria e aktit administrativ.

Së këndejmi, Gjykata vlerëson se përderisa vendimi i të paditurës për refuzimin e ankesës në procedurë administrative nuk është anuluar, apo në çfarëdo forme nuk është shpallur i kundërligjshëm, paditësi nuk posedon provë për të argumentuar veprimin e kundërligjshëm të

paditurit për veprimin dëmtues, ashtu që nuk argumentohet as ekzistimi i fajit në shkaktimin e dëmit pasi që paditësi është pajtuar se aktin administrativ, përkatësisht me Vendimin nr. 07/4/4577 të datës 17.11.2016 me të cilin është autorizuar vetëm pagesa e shumës prej 55,778.00€ dhe me Vendimin nr. 07/4/136 të datës 30.01.2017 me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit dhe se vendimin përfundimtar në procedurë administrative nuk e ka kontestuar me padi në konflikt administrativ me të cilin do të vërtetohej baza e kërkesëpadiisë së paditësit për mos përmbushjen e Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr. 13/2015 të datës 10.07.2015. Rrjedhimisht, nga Vendimi nr. 07/4/4577 i datës 17.11.2016 dhe Vendimi nr. 07/4/136 i datës 30.01.2017 të nxjerra nga AZHB, gjykata ka konstatuar se paditësi është pajtuar me vlerësimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë që vlera e përkrahjes me mjete publike të jetë vetëm në vlerë prej 55,778.00€ ndërsa të mos autorizohet pagesa në shumën prej 43,851.25€ për të cilën shumë i padituri në procedurë administrative ka konstatuar mos përmbushje të kontratës.

Gjykata vlerëson se për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet në vijim: të ekzistoj veprimi dëmtues, të jetë shkaktuar dëmi si dhe të ekzistoj lidhja kauzale midis veprimit dhe pasojës. Në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës nuk ekziston lidhja kauzale ndërmjet veprimit të pretenduar të organit administrativ dhe pasojës, pasi që gjykata në këtë çështje kontestimore nuk pati objekt shqyrtimi ligjshmërinë e vendimeve të lartcekura të cilat është dashur të jetë objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ e që do t'i paraprinte kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit.

Andaj, për vërtetimin e bazës juridike të një raporti detyrimor, siç është kërkesa për shpërblimin e dëmit, e cila rrjedh nga veprimi i kundërligjshëm i organit administrativ, duhet që me prova konkrete të dëshmohet se vendimi në procedurë administrative të ketë qenë i kundërligjshëm, me të cilin palës iu ka shkaktuar dëmi, ndërsa në këtë çështje paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se në procedurën administrative apo atë të konfliktit administrativ, i padituri të ketë vepruar në mënyrë të kundërligjshme, si pasojë e së cilit paditësit do t'i jepet e drejta për realizimin e detyrimit. Prandaj, gjykata e ka refuzuar kërkesëpadiinë e paditëses si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe faktin se në këtë çështje kontestimore më parë i janë aprovuar propozimet e përfaqësuesit të paditësit për nxjerrjen e provave përmes ekspertizave nga lëmia teknike, ndërtimtarisë dhe financiare, mirëpo gjykata vlerëson se pavarësisht konstatimeve që janë dhënë në këto ekspertiza, të njëjtat ishin pa ndikimin në vendosjen meritore të kësaj çështje, pasi që

gjkata erdhi në përfundim se paditësit i mungon baza juridike e kërkesëpadisë dhe nuk është lëshuar në vlerësimin e lartësisë së kompensimit. Lidhur me këtë, gjykata ka vlerësuar edhe udhëzimet e dhëna në Aktvendimin AE.nr. 101/2019 të datës 08.06.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës për konstatimin e drejtë të gjendjes faktike lidhur me pretendimet e të paditurit se paditësi nuk ka ofruar fatura në përputhje me UA.nr. 01/2015, neni 15 par.5, pika 5.5 si kusht për të përfituar pagesën dhe nëse ka ekzistuar detyrimi i të paditurit për pagesën për dy palë gërshtë, por për arsyet e njëjta që gjykata nuk ka vlerësuar provat e nxjerra përmes ekspertizave, vlerëson se pavarësisht konstatimeve lidhur me këtë gjendje faktike, e njëjta nuk do të kishte ndikim në krijimin e bazës ligjore të paditësit për kompensim.

5. *Shpenzimet e procedurës*

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1630/22, datë 29.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.